



# Trofeu ENDURO 2024

## Gara e pare Disiplina "Enduro" 14 Prill Divjake

### Kushtet e pergjithshme te regjistrimit

- Cdo pilot duhet te paguaj nje tarife regjistrimi prej 2500 lekesh te reja te pa kthyeshme per shpenzime Administrative.
- Cdo pilot duhet te jete i pajisur me patenten sportive 2024 te leshuar nga Federata Shqiptare e Motociklizmit per te cilen mund te aplikohet online ne linkun [www.amf.al](http://www.amf.al)
- Cdo pilot duhet te siguroje vete cdo shpenzim te tij (akomodim, ushqim, etj)

### Formula Sportive e garës.

#### 1.0 ORARET E EVENTIT

##### 1.1 14 Prill

Ora 08:00 - 09:00, Kontrolli Administrativ.  
Ora 09:00 - 10:00, Kontrolli Teknik i mjeteve dhe marrja e numrave.  
Ora 10:00 - 10:30, Mbledhja shpjeguese me garuesit.  
Ora 10:30 - 11:00, Përgatitja për prova te lira.  
Ora 11:00, Nisja e xhiros së provës.  
Ora 12:00, Mbyllja e hyrjes për në xhiron e provës.  
Ora 12:30, Start i garuesve.  
Ora 13:30, Mbyllja e garës.  
Ora 14:00, Ceremonia e ndarjes së çmimeve.

#### 2.0 IDENTIFIKIMI

- 2.1 Garuesit do të pajisen me tre numra stickers.
- 2.2 Një përpara dhe dy të tjerët majtas dhe djathtas në motor.
- 2.3 Marrja dhe ngjitja e numrit do të bëhet në procesin e kontrollit teknik.
- 2.4 Te gjitha mjetet do te perfshihen ne nje kategori.

#### 3.0 GARA

- 3.1 Gara do të jetë 20 (njetete) xhiro të pistës.
- 3.2 Gjatësia e xhiros 1.5 km.
- 3.3 Ora 12:30, Start i garuesve, nisja te gjithe njeheresh ne vije lineare
- 3.4 Koha maksimale për kryerjen e garës: 1 orë.
- 3.5 Ora 12:30 - Nisja e garuesve
- 3.6 Ora 13:30 - Mbyllja e garës
- 3.7 Garuesit mund të paraqiten në start për t'u futur në gare jo më vonë se ora 12:29:59.Pas kësaj ore nuk mund të futen dot më dhe për ta gara quhet e mbyllur.
- 3.8 Garuesit kanë kohë për të mbaruar garën jo më vonë se ora 13:30:00. Garuesit që mbërrijnë pas kësaj ore, do t'u llogaritet koha e xhiros së fundit të kryer sipas formule së penalizimeve.
- 3.9 Shkallezimi i pikeve per cdo gare ne renditje absolute;  
**30 pike** – Vendi i pare  
**24 pike** – Vendi i dyte  
**20 pike** – Vendi i trete  
Dhe ne vazhdim... **18/16/14/12/10/8/6/4/2/1**
- 3.10 Perllogaritja e pikeve mund te ndryshoje ne varesi te numrit te pjesemarrresve

#### 4.0 PENALIZIMET

- 4.1 Mos paraqitja në kontrollin administrativ brenda orës 09:00,përbën skualifikim nga gara.
- 4.2 Moskalim i kontrollit teknik, përbën moslejim të pjesëmarrjes në garë.
- 4.3 Mospagesa e tarifës se regjistrimit perben moslejim te pjesemarrjes ne gare.
- 4.4 Mospajisja me licencen sportive 2024 perben moslejim te pjesemarrjes ne gare.
- 4.5 Mosfirmosja e Kontratës së Pjesëmarrjes,përbën moslejim të pjesëmarrjes në garë.
- 4.6 Mosnisja për xhiron e provës deri në orën 11:45:00, garuesi e humbet të drejtën për të kryer xhiron e provës.
- 4.7 Mosmbarim i gares: Garuesi do te marrë pike minimale
- 4.8 Mosfutje në gare:Garuesi nuk perfiton pike per garen e rradhes
- 4.9 Garuesit që kanë arritur të futen në gare deri në orën 12:30 por nuk e mbarojnë dot deri në orën 13:00, do të marrin pike minimale.
- 4.10 Piket e perftuara nga te 3 tre garat e Enduros do te mblidhen per te shpallur fituesit e trofeut Enduro Albania.

#### 5.0 TROFETË

- 5.1 Për garuesit që do arrijnë të nisen: Certificate pjesmarrjeje.
- 5.2 Për tre vendet e para : Medalje për vendet 1/2/3.
- 5.3 Për renditjen e përgjithshme: Kupa per vendet 1/2/3 ne perfundim te 3 garave.
- 5.4 Ceremonia do të zhvillohet pranë finishit të garës në oren 14:00
- 5.5 Me perfundimin e gares se trete, fituesit pervec kupave do te perfitojne premium nga Shoqata Enduro Albania.

14 Prill 2024

Federata Shqiptare e Motoçiklizmit

Shoqata "Enduro Albania"